DOKUMENTI KONSULTATIV

Për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 27/2018, 'Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë', të ndryshuar[1]

Projektligji synon përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen, ruajtjen, administrimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe muzeve. Ai qartëson kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve, duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pasurive kulturore. Gjithashtu, përmirëson mekanizmat e financimit dhe mbështetjen për mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin e pasurive kulturore, përfshirë ato në pronësi jopublike. Projektligji parashikon vlerësimin e ndikimit të planeve dhe projekteve në trashëgiminë kulturore, si dhe mbrojtjen e peizazheve kulturore nëpërmjet planifikimit të integruar. Ai synon edhe forcimin e kontrollit të qarkullimit ndërkombëtar të objekteve kulturore dhe përmirësimin e procedurave për kthimin e pasurive kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimet në portalin e Regjistrit Elektronik: 20 ditë pune, duke filluar nga data 05 Nëntor 2026 deri në datë 3 Dhjetor 2026.

Si të përgjigjeni:

Kontributet që në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, do të përcillen nga institucionet e interesuara me anë të regjistrit elektronik në adresën http://www.konsultimipublik.gov.al.

Eliverta Vraniçi *Eliverta.Vranici@mtks.gov.al*

Datat dhe vendet e takimeve publike:

E-Konsultimi: në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” 20 ditë pune, duke filluar nga data 05 Nëntor 2026.

Sfondi i propozimit legjislativ

Propozimi legjislativ vjen si nevojë për përmirësimin e kuadrit ligjor të përcaktuar nga ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar, dhe përshtatjen e tij me nevojat e mbrojtjes dhe administrimit të trashëgimisë kulturore. Ndryshimet e propozuara synojnë qartësimin e kompetencave institucionale, përmirësimin e bashkërendimit ndërmjet strukturave përgjegjëse dhe rregullimin e mekanizmave të financimit të ndërhyrjeve ruajtëse. Një vëmendje e veçantë i kushtohet parandalimit të dëmtimeve që mund të shkaktohen nga projektet zhvillimore, përmes vlerësimit të ndikimit në trashëgiminë kulturore dhe planifikimit të integruar. Gjithashtu, propozimi adreson nevojën për rregulla më të qarta mbi importin, eksportin dhe kthimin e pasurive kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme, duke marrë në konsideratë instrumentet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare. Në këtë kuadër, ndërhyrjet e propozuara synojnë një sistem më funksional për ruajtjen e vlerave kulturore dhe administrimin e tyre në interes të publikut.

Propozimet

Përditësimin e përkufizimeve kryesore, që lidhen me konservimin, mirëmbajtjen, restaurimin, muzetë dhe menaxhimin e pasurive kulturore.
Qartësimin e kompetencave institucionale dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet ministrisë, institucioneve të specializuara dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.
Përmirësimin e mekanizmave të financimit, administrimit të të ardhurave dhe mbështetjes për pasuritë kulturore në pronësi jopublike.
Vendosjen e vlerësimit të ndikimit në trashëgiminë kulturore për planet, programet, projektet dhe ndërhyrjet që mund të cenojnë vlerat e saj.
Përmirësimin e rregullave për ndërhyrjet ruajtëse, përdorimin e pasurive kulturore dhe vlerësimin e tyre për shpronësim ose blerje nga shteti.
Rregullimin më të hollësishëm të tregtimit, importit dhe eksportit të objekteve kulturore, si dhe të procedurave për kthimin e pasurive të larguara në mënyrë të paligjshme.
Përditësimin e rregullave për pasurimin e fondeve muzeore dhe mbrojtjen e peizazheve kulturore nëpërmjet planifikimit të integruar.

Pyetjet

Reagimet që priten janë të hapura dhe nuk parashikohet ngritja e pyetjeve specifike, të cilat kërkojnë përgjigje. Pyetje të mundshme mund të jenë: A pajtoheni me qartësinë e informacionit të paraqitur në dokument dhe çfarë do të propozonit shtesë për të përmirësuar cilësinë e tij? Si i vlerësoni përcaktimet në këtë projektligj.